

Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, bazuar në dispozitat e nenit 1 kryerreshti 1.6 të Rregullores Nr.2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetqeverisjes në Kosovë.

Në pajtim me dispozitat e nenit 16 të Ligjit për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës,

Me qëllim të ndërmarrjes së masave parandaluese për evitimit e rreziqeve në punë, nxjerr :

RREGULLOREN Nr.2004/01

PËR MASAT HIGJENIKE DHE TEKNIKE TË SIGURISË NË PUNË

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME.

Neni 1.

1.1.Masat higjenike dhe teknike të sigurisë në punë, të parapara me këtë Rregullore, aplikohen në të gjitha vendet e punës, përveç në ato ku kryhen punë në kushte të veçanta, ku krahas këtyre, parashihen edhe masa tjera të veçanta të sigurisë në punë.

1.2.Për punët në të cilat punëmarrësi/it i'u ekspozohet/en rreziqeve, natyra e të cilave kërkon edhe masa tjera të veçanta për siguri në punë, përveç masave të parapara me këtë Rregullore, aplikohen edhe masat e tjera(të veçanta)të sigurisë në punë.

DETYRAT E PUNËDHËNËSIT

Neni 2.

2.1.Punëdhënësi është i obliguar që të gjitha vendet e punës dhe ato që lidhen me punën (punishtet, punëtoritë, ndërtesat, lokalet për pushim, ushqim,pastrim etj...), mjetet e punës, mjetet për siguri në punë, t'i rregulloj dhe t'i mirëmbaj në atë mënyrë, që të punësuarit dhe të tjerët të jenë të mbrojtur nga fatkeqësitë në punë, sëmundjet profesionale dhe sëmundjet e tjera lidhur me punën.

2.2.Punëdhënësi është i obliguar t'i parashohë, për të gjitha vendet e punës, rreziqet dhe masat e sigurisë në punë.

2.3.Nëse mjetet e punës, paisjet e punës, punishtja, punëtoritë etj..., paraqesin rrezik për jetën apo shëndetin e të punësuarve, punëdhënësi ose përsonei përgjegjës i tij, duhet menjëherë t'i largoj nga përdorimi.

2.4.Punëdhënësi është i obliguar që t'i njoftojë të punësuarit me normat e kësaj Rregullorje dhe të dispozitave të tjera të veçanta, që kanë të bëjnë me sigurinë në punë, mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës.

2.5.Vërejtjet për rreziqet në punë duhet të vihen në vende të theksuara dhe të dukshme.

2.6.Rrugët dhe daljet emergjente, duhet të jenë në çdo kohë pa pengesa dhe të shënuara qartë.

2.7.Punëdhënësi është i obliguar t'i ndërmarr të gjitha veprimet, që të punësuarit dhe të tjerët që kanë lidhje me punën, t'i aplikojnë dhe t'u përmbahen të gjitha masave të parapara të sigurisë në punë.

2.8.Punëdhënësi është i obliguar, për të krijuar kushte për bashkëpunim të të punësuarve për evitimin e shkaqeve të fatkeqësisë në punë.

2.9.Punëdhënësi është i obliguar për t'u kujdesur, që të gjitha mjetet e sigurisë në punë, në çdo kohë të jenë në gjendje të rregullt dhe të përdorshme. Në rast të prishjes me kohë të riparohen, kurse atyre që u ka skaduar afati të zëvendësohen me të reja.

2.10.Punëdhënësi është i obliguar t'i bëjë matjet dhe kontrollimet periodike të parametrave teknik të mjeteve dhe paisjeve të punës.

2.11.Me rastin e furnizimit me mjete të punës, lëndë të parë, aparate, mjete të transportit etj..., ato patjetër duhet të jenë të pajisura me mjete mbrojtëse dhe me ateste adekuate, konformë standardeve ndërkombëtare.

2.12.Kryerja e punëve në kushte të veçanta (me rrezikshmëri të lartë), ku parashihen masa të veçanta të sigurisë në punë, mund t'iu besohen vetëm të punësuarve profesional, të aftësuar për kryerjen e këtyre punëve. Kryesitë e këtyre punëve, apo ata që kanë qasje me to, duhet detajisht të informohen me rreziqet dhe masat për siguri në ato punë.

2.13.Punët të cilat kryhen nga disa të punësuar, për të pasur punë të sigurt kërkohet koordinim dhe marrëveshje midis tyre. Punëdhënësi ose personi përgjegjës i tij, duhet të caktojë një person me të cilin duhet t'i koordinojnë punët, i cili duhet të jetë në detaje i informuar për rrezikshmërinë dhe masat e sigurisë në ato punë.

2.14.Punëdhënësi është i obliguar, që të punësuarve në punë apo lidhur me punën, për kryerjen e të cilave kërkohen masa të veçanta të sigurisë në punë, paraprakisht t'iu kryej kontrollimin mjekësor. Të punësuarit në këto punë, duhet së paku një (1) herë në vit t'i nënshtrohen kontrollimit adekuat mjekësor.

DETYRAT E TË PUNËSUARVE

Neni 3.

3.1.Të gjithë punëmarrësit dhe të tjerët të angazhuar në punë apo lidhur me punën, janë të obliguar t'iu përmbahen të gjitha normave, udhëzimeve dhe dispozitave të tjera që kanë të bëjnë me parandalimin e rreziqeve në punë ose lidhur me punën, sëmundjeve profesionale dhe masave të tjera për mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës.

3.2.Punëdhënësi, udhëheqësi i repartit, kryepunëtori si dhe punonjësi të cilit i është caktuar ndonjë i punësuar në cilësi të ndihmësit ose për aftësim, janë të obliguar për t'i njoftuar të punësuarit me të gjitha rreziqet në punë dhe lidhur me masat e sigurisë në punë.

3.3.Të punësuarit që lëngojnë, apo kanë parashenja për të lëngur, nga ndonjë sëmundje (ataku, marramendje, shkurtpamësi, shtangim i muskujve e të ngjajshme), nuk mund të punësohen në punë ku paraqet rrezik për vetë ata dhe për të punësuarit e tjerë. Të

punësuarit nëse hetojnë shenja të këtyre sëmundjeve, janë të obliguar menjëherë për t'a lajmëruar punëdhënësin apo përgjegjësën e tyre.

SIGURIA E LËVIZJES NË PUNË

Neni 4.

4.1. Punëdhënësi është i obliguar, në ambientet e punës t'i eliminojë të gjitha pengesat për lëvizje, parregullësitë që paraqesin rrezik në punë dhe lidhur me punën. Në qoftë se nuk ka mundësi objektive për t'i eliminuar parregullësitë, duhet të izoloohen respektivisht rrethohen me rrethoja, të ndriçohen dhe shënohen në mënyrë adekuate.

4.2. Në qoftë se oborri i ndërmarrjes shërben edhe për deponim të materialit, lëndës së parë, atëherë ai duhet të rregullohet në atë mënyrë, që mos të pengohet lëvizja e lirë dhe mos të paraqitet rrezik në punë për të punësuarit.

4.3. Oborri i ndërmarrjes, të gjitha vendet e punës dhe ato lidhur me punën, gjatë punës në turnin e natës, duhet të jenë të ndriçuara, kurse vendet që paraqesin rrezik në punë apo lidhur me punën (gropat, kanalet etj), duhet të shënohen (fiksohen) me shenjën që paraqet rrezik.

4.4. Dyshemeja, hyrje-daljet dhe të gjitha vendet e punës, duhet të jetë në gjendje të rregullt. Vendet e rrëshqitshme në dysheme, duhet të mirëmbahen dhe të shënohen qartë.

4.5. Vendet e rrezikshme të punës, duhet të shënohen qartë me tërheqje të vërejtjes për rrezikshmëri (rrezik për jetë, tensioni i lartë, mos prek etj...).

4.6. Lokalet me stabilimente elektrike (të cilat paraqesin rrezik), gjatë gjithë kohës duhet të mbyllën e t'u lejohet qasja dhe qëndrimi vetëm personave të autorizuar dhe profesional.

4.7. Në lokalet e punës, ndërprerësit e rrymës, duhet të instalohen në vende të përshtatshme dhe të papengueshme.

4.8. Dyert kryesore të lokaleve të punës (hyrje-daljet kryesore), duhet të jenë të gjëra së paku dy (2)m, ndërsa ato ndihmëse së paku një (1)m.

4.9. Në të gjitha vendet ku punohet (punëtori, reparte etj...), të gjitha hyrje-daljet dhe kalimet e tjera (qarkullimi në punë), nuk guxon të ketë pengesa të cilat do të kishin penguar apo vështirësuar daljen, respektivisht lëvizjet në punë.

4.10. Të punësuarit duhet t'i shfrytëzojnë vetëm ato hyrje-dalje, respektivisht kalime të caktuara për ta. Nuk guxon të kalohet nga një repart në tjetrin pa leje të përgjegjësit.

4.11. Gjatë ngritjes dhe bartjes së ngarkesave me vinç, ndalohet çdo kalim apo qëndrim nën ngarkesa.

4.12. Të gjitha shkallët, kalimet, urat, etj..., të cilat janë mbi tokë në lartësi mbi një (1)metër, duhet të kenë patjetër rrethojën në lartësi adekuate.

4.13. Për ngritje dhe bartje të ngarkesave, duhet të përdoren mjetet adekuate të atestuara dhe duhet të aplikohen masat mbrojtëse adekuate.

4.14. Skelat të cilat përdoren në punë, duhet të jenë nga materiali i qëndrueshëm dhe të siguruara nga rrëshqitja, thyerja, rënia apo luhatja.

4.15. Gropat, kanalet apo rezervuarët e ndryshëm, ku deponohen materje, respektivisht materiale helmuese etj..., që paraqesin rrezik, duhet të rrethohen me rrethoja të

sigurta, ndërsa ato vende të cilat nuk mund të rrethohen duhet të janë të ndriçuara mirë dhe në vende të theksuara duhet të vihen shenjat e paralajmërimit të rrezikut.

SIGURIA KUNDËR ZJARRIT.

Neni 5.

5.1. Punëdhënësi ose personat e tjerë përgjegjës, janë të obliguar që t'i caktojnë dhe ndërmarrin masat adekuate për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtim të atyre që janë të rrezikuar nga ai.

5.2. Objektet e destinuara për punë, sidomos ato shumëkatëshe, duhet t'i kenë daljet emergjente dhe mjetet e tjera për shpëtim.

5.3. Daljet gjatë kohës së punës nuk guxojnë të mbyllen e as të pengohen, kurse ato për raste emergjente, duhet të shënohen qartë dhe të hapen lehtë, hapja duhet të bëhet në kahje të daljes.

5.4. Numri dhe madhësia e aparateve për fikjen e zjarrit dhe sistemi i hidranteve, duhet të jenë konformë hapsirës së lokalit të punës, destinimit të objektit dhe në çdo kohë të janë të atestuara e të përdorshme.

5.5. Njohuri elementare për përdorimin e aparateve për fikjen e zjarrit dhe për evakuim, duhet të kenë të gjithë të punësuarit, ndërsa një numër i caktuar i punëmarrësve duhet të janë të aftësuar për këtë çështje.

5.6. Për fikjen e zjarrit të disa materialeve, respektivisht materjeve, paisjeve (vajëra llaqe, bojëra, elektromotora etj...), nuk guxon të përdoret uji e as nuk guxon të lihet afër, por duhet të përdoren materiale dhe aparate adekuate për fikjen e zjarrit (rërë, aparate me mbushje adekuate etj.).

5.7. Në rast të zjarrit, duhet pasur kujdes për ndaljen e makinerisë dhe të rrymës elektrike.

5.8. Punëdhënësi është i obliguar, në vende të theksuara e të dukshme të vendosë udhëzimet detaje, në rast të zjarrit.

5.9. Punëdhënësi është i obliguar, që të organizojë shërbimin kundër zjarrit konformë dispozitave pozitive.

PUNA ME MATERIALE SHPËRTHYESE DHE NDEZËSE

Neni 6.

6.1. Me shkrim duhet të ndalohet përdorimi i gjëseneve që shkaktojnë flakë, shkëndija, materialeve të tjera ndezëse, rrobave e materialeve që kanë elektricitet statik dhe pirja e duhanit në lokalet ku punohet apo vendosen materiale që ndizen lehtë.

6.2. Derivatet e naftës dhe materialet e tjera të ngjajshme që ndizen lehtë, nuk guxojnë të vendosen me materiale të tjera, ato duhet të vendosen në lokale të veçanta, ndaras me lokalet e punës dhe të banimit.

6.3. Vendin dhe mënyrën e vendosjes së materialeve shpërthyesë që ndizen lehtë, punëdhënësi duhet t'a rregullojë me akt juridik të veçantë.

6.4. Vendet e punës ku punohet me materiale shpërthyesë apo që ndizen lehtë, duhet të sigurohen në atë mënyrë që të parandalohet fatkeqësia në punë. Ndriçimi dhe

temperatura e këtyre lokaleve duhet të bëhet në atë mënyrë , që të eliminohen të gjitha rreziqet nga zjarri ose shpërthimi.

6.5.Lokalet në të cilat vendosen materiale tek të cilat zhvillohen temperatura apo kushte shpërthyesë, që paraqesin rrezik jo vetëm për ato, por edhe për lokalet e tjera, duhet të aplikohen këto masa:

-instalimi elektrik, duhet të bëhet në tërësi, në pajtim me kushtet, dispozitat dhe standardet e caktuara për lokale ku ka rrezikshmëri nga zjarri, respektivisht shpërthimi;

-dyert, dritaret dhe dyshemeja duhet të jenë nga materiali që nuk ndizet;

-në këto lokale nuk guxon të përdoret flaka e hapur apo mjete që e shkakton zjarrin, ndriçimi duhet të bëhet nga mjete që e ka të izoluar burimin që mund t'a shkaktojë zjarrin;

-këto lokale nuk guxojnë të ngrohen me stufa apo mjete të tjera me flakë ose zjarrë të hapur;

-në këto lokale, rreptësisht ndalohet pirja e duhanit dhe

-të gjitha veglat, paisjet dhe mjetet e punës, duhet të izoloohen dhe tokëzohen në mënyrë adekuate.

Këto dhe masat e tjera, duhet të vihen në hyrje të lokaleve (vende të dukshme e të theksuara).

6.6.Në lokalet e punës ndalohet çdo grumbullim i materialeve, respektivisht materjeve apo hedhurinave që ndizen lehtë ose vetvetiu. Për vendosje të përkohshme të tyre, duhet të përdoren katinjerët, respektivisht enë nga materiali që nuk digjet, që mbyllën hermetikisht, duke shënuar përmbajtjen e materialeve, respektivisht materjeve, dhe të vendosen në vende të sigurta.

6.7.Të punësuarit në këto punë nuk guxojnë të veshin rroba që ndizen lehtë (me vajra të ndryshme apo që kanë materje që ndizen lehtë).

PUNA ME HELME APO MATERIALE QË PËRBËJNË MATERJE HELMUESE

Neni 7.

7.1.Materjet helmuese apo materialet që përbëjnë materje helmuese, duhet të mbahen në vende të veçanta e të sigurta, të mbyllura me çelës dhe nën mbikqyrje të përhershme. Në këto materje, respektivisht materiale, kanë qasje vetëm punonjësit profesional e në sasi të nevojshme për punë.

7.2.Mjetet (enët, katinjerët etj...) ku deponohen (mbahen) materjet helmuese, respektivisht materialet që përbëjnë materje helmuese, duhet të jenë për nga forma dhe pamja të dallueshme nga mjetet e tjera dhe dukshëm duhet të shënohet përmbajtja e këtyre materjeve me shenjën e rrezikut nga helmimi.

7.3.Spërkatjet, respektivisht të rrjedhurat e tjera apo shkapërderdhja e këtyre materjeve, gjegjësisht materialeve, menjëherë dhe me kujdes të veçant duhet të izolohet, duke i evituar të gjitha ndikimet e dëmshme.

7.4.Bartja e këtyre materjeve, respektivisht materialeve, prej një vendi në vendin tjetër apo prej një ene, në enën tjetër, duhet të bëhet në mënyrë të sigurt dhe profesionale. Në ato raste ku bartja bëhet në mënyrë tjetër (mekanike), duhet patjetër të përdoren

mjetet që eliminojnë rrezikun e derdhjes, respektivisht spërkatjes apo shkapërderdhjes së këtyre materjeve.

7.5.Në këto punë nuk guxojnë të punojnë ata që nuk janë të aftësuar.

7.6.Rreptësisht është e ndaluar vendosja, konkretisht varja e rrobave në lokalet e punës. Ato duhet të vendosen në lokale (vende) të caktuara jashtë tyre.

IZOLIMI NGA RRYMA ELEKTRIKE E MJETEVE DHE E INSTRUMENTEVE TË PUNËS

Neni.8.

8.1.Të gjitha mjetet, instrumentet dhe paisjet e punës, duhet të izoloohen nga rryma elektrike konformë dispozitave pozitive dhe standardeve ndërkombëtare të pranuar.

8.2.Konform dispozitave dhe standardeve ndërkombëtare, duhet të bëhet tokëzimi i të gjitha instalimeve elektrike.

8.3.Mbrojtja nga tensioni i lartë, duhet të bëhet në tërsi sipas dispozitave pozitive dhe standardeve ndërkombëtare të pranuar.

8.4.Mbrojtja nga mbitensionet atmosferike, duhet të bëhet në tërsi sipas dispozitave pozitive dhe standardeve ndërkombëtare të pranuar.

8.5.Mbrojtja nga tensioni i hapit dhe i prekjes duhet të bëhet në bazë të dispozitave pozitive dhe standardeve ndërkombëtare të pranuar.

8.6.Mbrojtja nga rryma elektrike, në objekte ku materjet kimike janë burime të energjisë elektrike, duhet të bëhet në tërsi sipas dispozitave pozitive dhe të standardeve ndërkombëtare të pranuar.

8.7.Mbrojtja nga elektriciteti statik, duhet të bëhet në tërsi sipas dispozitave pozitive dhe standardeve ndërkombëtare të pranuar.

SHARRAT

Neni 9.

9.1.Sharrat për sharritje, duhet të jenë të pajisura me të gjitha mjete mbrojtëse.

HIGJIENA E PUNËS

PASTRIMI I LOKALEVE TË PUNËS

Neni 10.

10.1.Vendet e punës, konkretisht lokalet e punës, duhet të jenë të pastruara.

10.2.Së paku një (1) herë në javë detajisht duhet të pastrohen të gjitha lokalet dhe vendet e punës.

10.3.Nëse pastrimi duhet të bëhet gjatë orarit të punës, duhet pasur kujdes nga pluhuri.

10.4.Uji dhe mjetet e tjera që përdoren për pastërti nuk guxojnë të jenë të dëmshme për shëndetin.

10.5.Gëlqerosja e lokaleve duhet të bëhet së paku një (1) herë në vit.

10.6.Vendi për vendosje dhe ushqim, duhet të jetë i pastër dhe i pajisur në mënyrë adekuate.

10.7.Në të gjitha lokalet e punës dhe ato ndihmëse, duhet të vendoset mjete adekuat për pështyrje i mbushur me ujë e me kapak adekuat.

10.8.Toaletet duhet të jenë të ndara, të shënuara (meshkuj-femra), në çdo kohë funksionale dhe të pastruara.

10.9.Vendet për pastrim, duhet të jenë të ndara (meshkuj-femra), funksionale dhe të pajisura në mënyrë adekuate.

10.9.Vendet për ndërrimin e rrobave, duhet të jenë të caktuara, të ndara (mëshkuj-femra), të pastruara dhe të pajisura me mjete adekuate.

10.10. Punëdhënësi është i obliguar që t'i sigurojë mjetet për këtë qëllim dhe t'ua lërë në shërbim të punësuarve.

PASTRIMI, ZBRAZJA DHE MIRËMBAJTJA E FURRAVE

Neni 11.

11.1.Furrat mund të zbrazen vetëm atëherë kur të shuhet zjarri dhe muret e furrës të jenë ftohur, në masë të lejuar .

11.2.Nëse furra duhet të zbrazet me presion, zbrazja duhet të bëhet me kujdes të veçantë dhe me presion sa më të ulët.

11.3.Furra guxon t'ia filloj punës pasi të jetë ftohur dhe pasi të konstatohet rregullsia e saj, të mbushet dhe t'ia fillojë punës.

11.4.Furra duhet pastruar rregullisht dhe ruajtur nga ngricat dhe lagështia.

11.5.Furrat duhet të jenë të pajisura me mjete, vegla, instrumente dhe pajisje të tjera mbrojtëse.

11.6.Lidhur me pastrimin, zbrazjen dhe mirëmbajtjen e furrave, duhet të bihen akte juridike të veçanta.

SHKARTI DHE HEDHURINAT E TJERA

Neni 12.

12.1.Shkarti dhe hedhurinat e tjera, për çdo ditë, duhet të largohen nga lokalet e punës në vendin e caktuar. Nëse kemi të bëjmë me materje, respektivisht materiale që përbëjnë materje helmuese, duhet të vendosen në mjete (kantinjerë apo enë) të metalta me mbyllje hermetike, të cilat duhet të zbrazen dhe pastrohen për çdo ditë e sipas nevojës edhe të dezinfektohen.

12.2.Dyshemetë, ku mbahen këto materje, respektivisht materiale, duhet të jenë të izoluar në mënyrë që këto mos të depërtojnë poshtë, muret duhet të janë të ngjyrosura me ngjyrë të yndyrshme apo nga materiali që lehtë mund të pastrohet. Këto lokale për çdo ditë duhet të pastrohen e sipas nevojës edhe të dezinfektohen.

12.3.Ujërat e kontaminuara (të infektuara, të helmuara), drejtëpërsëdrejti, duhet të derdhen në deponi të izoluar, të cilat zbrazen nga të punësuarit profesional.

DISPOZITAT E TJERA

Neni 13.

13.1.Të punësuarit që punojnë në repartet me makineri, nuk guxojnë të veshin rroba të gjëra, shalla, unaza etj.

13.2.Nëse punonjësi/it mban/jnë flokë të gjata ato duhet të lidhen.

13.3.Nëse duhen përvjelur mëngët ato duhen përvjelur në anën e brendshme.

13.4.Gjatë orarit të punës ndalohet përdorimi i alkoolit. Përsonave të dehur nuk u lejohet qëndrimi, e as puna në lokalet e punës.

13.5.Në ndërmarrje ku aplikohen masat e veçanta të sigurisë në punë, për shkak të mundësisë së sëmundjeve profesionale, të punësuarit në lokalet e punës nuk guxojnë të hanë, përtypin e as të pijnë duhan.

MBIKQYRJA

Neni 14.

15.1.Mbikqyrje në aplikimin e dispozitave të kësaj Rregullorje, ushtron Agjencioni Ekzekutiv i Inspektoriatit të Punës.

DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 15.

16.1.Dispozitat e kësaj rregullorje aplikohen në tërë territorin e Kosovës.

16.2.Punëdhënësit obligohen që të sigurojnë kushtet dhe masat për aplikimin e dispozitave të kësaj rregullorje, në afat prej tre (3) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të saj.

HYRJA NË FUQI

Neni 16.

17.1.Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Prishtinë, 18. mars. 2004

**M I N I S T R I
I PUNËS DHE MIRËQENJES SOCIALE
Ahmet Isufi**